

RAPORT

“Vlerësim i Programit të Zhvillimit të Kapaciteteve të Studentëve - Edicioni II i Debatit Universitar për Integrimin”

Në kuadrin e projektit ‘Debati universitar për integrimin: Edicioni 2 - Nga fjala tek veprimi’
me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë

Përmbajtja

<i>Hyrje</i>	3
Objektivat e trajnimeve	4
Organizimi i trajnimeve	4
<i>Rezultatet e Vlerësimit të trajnimeve</i>	5
Metodologjia e vlerësimit	5
Rezultatet e pyetësorit	5
<i>Konkluzione</i>	10
<i>Rekomandime</i>	11

Hyrje

SCiDEV, bazuar në përvojën e krijuar dhe në interesin e ngjallur nga universitetet, pedagogët dhe studentët gjatë edicionin të parë “Laboratori i debatit mbi integrimin europian në auditorët universitare” (2019-2020), mbështetur nga Fondacioni për Shoqëria e Hapur për Shqipëri, nisi në Shtator 2020 një edicion të dytë të debatit, por duke pasur parasysh kontekstin e ri ku veprimi jo vetëm me hapjen e negociatave, por edhe me krizën shumë dimensionale social-ekonomike të shkaktuar nga COVID-19 si edhe me nevojën për një rini të angazhuar dhe të motivuar.

SCiDEV në edicionin e dytë të debatit universitar për integrimin iu përshtat dinamikave të reja të krijuara dhe sidomos kërkesës së studentëve jo vetëm për të qenë pjesë të debatit, por edhe për t’i mbështetur ata me një program të rritjes së kapaciteteve mbi veprimin dhe mbështetjen e të rinjve për aktivizim, sidomos aktivizim online. Në fazën e dytë u sugjerua përfshirja e 12 institucioneve për të patur mundësinë e thellimit të punës me studentët në Tiranë dhe Durrës dhe zgjerimi në Vlorë.

Programi ‘Zhvillimi i kapaciteteve për studentët dhe kërkuesit e rinj’ është ndalur jo vetëm tek tematikat dhe formati i debatit (këto instrumente janë ndërtuar nga edicioni i parë dhe janë online), por tek aktivizimi, angazhimi dhe pjesëmarrja përmes zhvillimit të njohurive dhe aftësive sa i takon proceseve vendimarrëse brenda në Shqipëri e më gjerë, universitet, në komunitet, qytet në aspektin e angazhimit publik dhe politik kombëtar.

Tematikat e përzgjedhura si: aktivizimi publik dhe politik i të rinjve; njohja e të drejtave dhe detyrimeve si studentë; si të influencojnë drejtimin e universitetit, si të ndërmarrin fushata ndërgjegjësuëse, të bëjnë aktivizim online, si të përdorin mjetet digjitale për të ndërmarrë veprime konkrete si qytetarë të angazhuar në jetën publike, u mirëpritën nga studentët dhe do të përkthehen në veprime konkrete të tyre gjatë realizimit të projektit sidomos në fushatën ‘Nga fjala tek veprimi’.

Në këtë kuadër ky raport synon të nxjerri disa konkluzione konkrete mbi vlerësimin e studentëve pjesëmarrës në programin e rritjes së kapaciteteve por edhe disa rekomandime, mbështetur mbi analizën e të dhënave të mbledhura me anë të një pyetësi.

Objektivat e trajnimeve

Programi ‘Zhvillimi i kapaciteteve për studentët dhe kërkuesit e rinj’ ka këto objektiva:

- ⇒ Dizajnimi i programit të zhvillimit të kapaciteteve për studentët dhe kërkuesit e rinj
- ⇒ Njohja dhe zhvillimi i aftësive kritike, aktivizimi, veprimi dhe jeta publike dhe politike.
- ⇒ Njohja e të drejtave dhe detyrimeve si studentë; si të influencojnë drejtimin e universitetit, si të ndërmarrin fushata ndërgjegjëse, të bëjnë aktivizim online.
- ⇒ Njohja dhe zhvillimi i aftësive si të përdorim mjetet digjitale për të ndërmarrë veprime konkrete si qytetarë të angazhuar në jetën publike.
- ⇒ Identifikimi i disa ideve dhe veprimeve konkrete nga studentët dhe kërkuesit e rinj.

Organizimi i trajnimeve

SCiDEV organizoi 9 seanca trajnimi duke i ndarë studentët (104 në total) në tre grupe për të krijuar hapësira për trajnuesit për të punuar me grupe të vogla. Numri total i pjesëmarrësve ishte **84** studentë nga 12 universitete partnere. Në kuadër të masave kundër COVID-19, trajnimet u zhvilluan online përmes platformës Zoom dhe u promovuan si para dhe pas në rrjetet sociale të SCiDEV. Videot e plotë janë të disponueshme online në një faqe të dedikuar për [Programi ‘Zhvillimi i kapaciteteve për studentët dhe kërkuesit e rinj’](#).

Trajneri	Tema	Datat	Ora	Grupet
Prof. Nevila Xhindi	Aktivizimi publik dhe politik	2 dhjetor 15 dhjetor 18 dhjetor	14:00 – 16:00	Grupi i parë datë 2 Grupi i dytë datë 15 Grupi i tretë 18
Dr. Dorina Gjipali	Pjesëmarrja në proceset vendimmarrëse: Arsimi i lartë	11 dhjetor 12 dhjetor 13 dhjetor	11:00 – 13:00	Grupi i parë datë 11 Grupi i dytë datë 12 Grupi i tretë 13
Dr. Fabjan Lashi	Përdorimi i mjeteve digjitale për aktivizim	3 dhjetor 10 dhjetor 17 dhjetor	10:00 – 12:00	Grupi i parë datë 3 Grupi i dytë datë 10 Grupi i tretë 17

Rezultatet e Vlerësimit të trajnimeve

Metodologjia e vlerësimit

Grupi i punës për realizimin e trajnimeve dhe menaxheri i projektit realizuan një [pyetësor online](#) për vlerësimin e Programit të zhvillimit të kapaciteteve. Qëllimi i pyetësorit ishte vlerësimi i trajnimeve në aspektin personal, perceptimi i studentëve mbi përfitimet nga pjesëmarrja në trajnime, si dhe në aspektin e ndikimit që këto trajnime patën referuar aktivizmit dhe veprimtarive konkrete që do të gjenerohen e ndërmerren në këtë edicion të dytë të projektit.

Pyetësi përmban 11 pyetje, prej të cilave 7 pyetje të mbyllura (me mundësi zgjedhjeje midis disa përgjigjeve, po/jo ose me vlerësim 1-5) dhe 3 pyetje të hapura me qëllim që studentët të shprehin mendimin e tyre mbi vlerësimin e aspekteve të ndryshme të programit të rritjes së kapaciteteve. Link-u i pyetësorit iu dërgua të gjithë studentëve pjesëmarrës si përfaqësues të 12 universiteteve të angazhuara në projekt.


1. Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike, Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës (FSHJP/UAMD)
2. Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Universiteti Bujqësor i Tiranës.
3. Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës (FSHS/UT)
4. Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës (FE/UT)
5. Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës (FD/UT)
6. Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës (FHF/UT)
7. Instituti i Studimeve Europiane, Universiteti i Tiranës (ISE/UT)
8. Universiteti European i Tiranës (UET)
9. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH)
10. Kolegji Universitar Marlin Barleti (MB)
11. Kolegji Universitar Luarasi (Luarasi)
12. Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti Ismail Qemali, Vlorë (UV)

Rezultatet e pyetësorit

Pyetësorit i janë përgjigjur 58 studentë brenda afateve kohore të përcaktuara ose 70% e pjesëmarrësve. Pyetjet e mbyllura synonin të mblidhnin të dhëna mbi të studentët (ciklin e studimeve, pjesëmarrja në edicionin e parë dhe Universitetin të cilit i perkisnin si dhe vlerësimet të përgjithshme rreth programit të rritjes së kapaciteteve.

Kështu, referuar pyetjes të ciklit të studimeve që ndjekin studentët, vihet re se përqindja më e lartë, 48,3 % e studentëve që plotësuan pyetësorin, janë në master shkencor (Grafiku 1), shumë me rëndësi për qëllimet e projektit, ku duhet theksuar fakti i mundësive reale për aktivizmin e tyre publik dhe politik.


Grafiku 1. Cikli i studimit të studentëve pjesëmarrës në program



65.5% e studentëve dhe kërkuesve të rinj që morën pjesë në programin e trajnimit, nuk kanë qenë pjesë e edicionit të parë të debatit, pra janë pjesëmarrës të rinj në këtë edicion të dytë.


Studentët kanë bërë një vlerësim mbi vlerën e shtuar të këtij edicioni të dytë (Grafiku 2), ku nga përgjigjet vihet re se ata i konsiderojnë vlerë të shtuar risitë e edicionit të dytë duke evidentuar fushatën “Nga fjala tek veprimi”, njoftimet e SCiDEV për aktivitete, intershipe etj. si dhe programin e rritjes së kapaciteteve.

Grafiku 2. Vlera e shtuar e pjesëmarrjes në edicionin e dytë.




Në një vlerësim mbi modulet e programit të rritjes së kapaciteteve, ku studentët ndihen më mirë pas trajnimit, vihet re se përqindjen më të lartë, 32,8 % e ka Moduli “Aktivizimi publik dhe politik” i zhvilluar nga Prof.Assoc.Dr. Nevila Xhindi. (Grafiku 3)

Grafiku 3. Modulet ku studentët ndihen më mirë




Ndërkohë që 60% e studentëve pjesëmarrës në pyetësor e vlerësojnë me 5 (nga 1-5), programin e zhvillimit të kapaciteteve, 31% me 4 dhe 8,6% me 3 (Grafiku 4). Të dhëna këto që theksojnë edhe një herë se programi i rritjes së kapaciteteve është mirëpritur dhe vlerësuar nga studentët jo vetëm në kuadër të thellimit të njohurive mbi tematikat e zgjedhura por edhe si shtysë dhe nxitje e mëtejshme për ndërmarrjen e veprimeve konkrete.

Grafiku 4. Vlerësimi i programit të zhvillimit të kapaciteteve




Duke analizuar përgjigjet e pyetjes “Vlerësimi i programit të zhvillimit të kapaciteteve sipas disa treguesve” (Grafiku 5), rezulton se 70% e studentëve vlerësojnë si parësor treguesin: Tematikat e përzgjedhura dhe burimet. Studentët kanë vlerësuar gjithashtu Komunikimin gjatë trajnimeve, Ekspertizën e trajnuesve, Organizimin e trajnimeve etj.

Grafiku 5. Vlerësimi I programit të zhvillimit të kapaciteteve sipas disa treguesve



Nevojat e studentëve për të rritur angazhimin dhe aktivizimin publik dhe politik evidentohen në Grafikon 6. Nga analiza e përgjigjeve të studentëve rezultojnë se 58 % e tyre vlerësojnë si nevojë primare, Financimin dhe mbështetjen për organizimet studentore/rinore ndjekur nga nevoja për Njohuri të mëtejshme për proceset vendimarrëse dhe konsultimet si dhe rritjen e metejshme të kapaciteteve.

Grafiku 6. Nevojat e studentëve për të rritur angazhimin dhe aktivizimin publik dhe politik



Pyetësi kishte edhe 3 pyetje të hapura për të cilat studentët shprehën mendimin e tyre. Në vijim është bërë një përmbledhje për të tre pyetjet e hapura referuar përgjigjeve të studentëve që evidentohen më shumë.

Bazuar në përmbledhjen e përgjigjeve të studentëve referuar yetjes "Çfarë ndryshoi tek ju pas këtyre trajnimeve?", përgjigjet e studentëve që evidentohen më së shumti janë:

- Të treja trajnimet ishin nxitëse për qasje drejt zhvillimit personal në dimensione si mendimi kritik e deri te aftësite teknike apo drejt aktivizimit qytetar.
- Pas realizimit të trajnimeve arrita të merrja më tepër informacion për të gjitha temat e trajtuara të cilat u përcollën shumë qartë nga trajnuesit tek ne studentët.
- Një nga gjërat që këto trajnime më dhanë është të parit të gjërave ndryshe si dhe të kuptoja sesa i rëndësishëm është studenti dhe sesa shumë gjëra mund të ndryshojmë ne.
- Ndryshoi mënyra e perceptimit sesi të jemi më vendimarrës dhe të bëjmë më shumë për shoqërinë tonë. Të japim një kontribut në arsim por edhe për aktivizimin publik dhe politik.
- Kam përfituar informacione të ndryshme për secilën prej temave, dhe është rritur niveli i interesit për ti futur njohuritë e marra në përdorim si një aktivist i shoqërisë civile.
- Kam një pamje më të qartë përsa i përket aktivizimit të të rinjve, pjesëmarrja në proceset vendimmarrëse dhe për përdorimin e mjeteve digjitale.

Tematikat e përzgjedhura për trajnim janë përkufizuar si interesante dhe zgjedhja e duhur nga studentët. Kjo evidentohet edhe në përgjigjet e tyre kundrejt pyetjes Cilat janë disa nga temat që do të donit të thelloheshin më shumë?. Propozimet e përmbledhura të studentëve dhe që përsëriten në më shumë janë:

- Aktivizimi politik dhe publik i të rinjve
- Pjesëmarrja e studentëve në jetën politike dhe roli i tyre
- Roli dhe pjesëmarrja e të rinjve në proceset vendimmarrëse në arsimin e lartë
- Përdorimi i mjeteve digjitale për aktivizimin rinor
- Demokracia ne vend. Kriza e demokracisë
- Bashkimi Evropian, politikat dhe integrimi në BE
- Dixhitalizimi dhe përdorimi i teknologjisë

Disa nga aksionet/idetë për veprim të propozuara nga studentët në pyetësor, bazuar edhe në njohuritë e marra në 3 trajnimet e zhvilluara janë:

- Organizimi i fushatave publike të organizuara nga të rinjtë me fokus nxitjen e aktivizimit dhe çrrënjosjen e idesë së përgjithshme që ekziston në mes të rinjve mbi politikën dhe politikëbërjen.
- Lobimi me fort i zërit të të rinjve pranë IAL-ve. Angazhimi në jetën aktive dhe vendimarrëse nepërmjet strukturave të ndryshme për zhvillim, sidomos fushave që i përkasin dijes dhe jetës akademike.
- Aktivizimi në komunikim politik në platforma online (podcast) si formë alternative kundrejt mediave private tradicionale.
- Media contact cultivation: Krijimi i një website, i cili ndihmon studentët në dhënien e informacioneve specifike për ta, duke qenë se ky i fundit mungon.
- Bashkëpunimi me të rinjtë e tjerë në fusha të ndryshme, duke krijuar Klube Studentore sa i përket jetës studentore dhe debate sa i përket jetës sonë publike si qytetarë.
- Pas trajnimit me temë "Pjesëmarrja në proceset vendimmarrëse" një ide e imja për të ardhmen është marrja pjesë si përfaqësuese në Keshillat Studentor.

- Angazhimi i studentëve në jetën studentore dhe angazhimi i studentëve në sferën sociale si dhe marrja pjesë e tyre në kauza si psh barazia gjinore, dhuna ndaj gruas çështje të lidhura me mjedisin etj.
- Nisja e fushatave për ndërgjegjësimin e studentëve dhe fuqinë që ata zotërojnë për të sjell ndryshimin.
- Përdorimi i software të prezantuara tek trajnimi i dytë dhe te parit e aktivizimit qytetar, të përmendur tek trajnimi i parë, si një opsion shumë dobiprures për të shfrytëzuar hapësira kohe në të ardhmen.

Konkluzione

Pyetësi “Vlerësim i Programit të Zhvillimit të Kapaciteteve të Studentëve - Edicioni II i Debatit Universitar për Integrimin” i organizuar nga SCiDEV konfirmoi se përzgjedhja e tematikave për trajnim dhe përgatitja e tyre kanë qenë shumë serioze dhe janë mirëpritur nga studentët.

Tematikat e trajnimeve kanë sjellë përforsim të analizës dhe të menduarit kritik, etikë të lartë në komunikim, tolerancë dhe vlera të qytetarisë aktive mes studentëve dhe kërkuesve të rinj.

Trajnimet nxorrën në dukje interesimin e studentëve për tu thelluar edhe më tepër lidhur me temat e trajtuara por edhe domodoshmërinë e trajnimeve të tilla që i nxisin ata për të qenë më aktiv në jetën publike dhe politike.

Programi i zhvillimit të kapaciteteve të studentëve bashkoi studentë të 12 universiteteve, të cilët bashkëbiseduan, ndanë mendime e dhanë propozimet e tyre duke kontribuar kështu në rritjen e ndërgjegjësimit të tyre për rolin e tyre si student dhe qytetar.

Rekomandime

- Të punohet për rritjen e vazhdueshme të kapacitetve të studenteve si të rinj aktivistë dhe të angazhuar në shoqëri.
- Të hartohet një strategji komunikimi dhe çdo aktivitet/angazhim publik të promovohet në rrjetet sociale nga vetë studentët dhe universitetet për të siguruar dukshmëri, por edhe për të rritur ndërgjegjësimin e të rinjve për të marrë pjesë aktive në shoqëri.
- Të synohet që në aktivitetet e ardhshme që do të organizojë SCiDEV të fokusohet në nevojat dhe propozimet e studentëve të evidentuara në këtë raport.
- Të synohet gjithëpërfshirja e studentëve në trajnime dhe aktivitete me qëllim ndërgjegjësimin e studentëve për rolin e tyre në komunitet dhe shoqëri.
- Të zhillohet edhe më tej Programi i Trajnimeve me më shumë tema, takime e diskutime me interes për studentët.
- Të zhvillohen më tej përdorimi i mjeteve digjitale për aktivizim dhe angazhim publik.
- Të përforcohet bashkëpunimi me aktorë të tjerë me fokus të rinjtë dhe studentët.

